

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA MINISTRI E MEDITERRANIT, PLANIMIT DHE INFRASHTRUKTURE MINISTRI E MEDITERRANIT, PLANIMIT DHE INFRASHTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	DP/INB / /
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Datum Date	8658/24 31.12.24 No. 1
PRISHTINE / A	

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 12, paragrafit 3, nën-paragrafit 3.4 dhe Nenit 22, të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

RREGULLORE PËR SHUMAT E KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E ORGANEVE TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i shumave të kompensimit për anëtarët e organeve të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda).

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën dhe anëtarët e organeve të Odës që kanë të drejtë në shumat e kompensimit.

Neni 3

Përkufizimet

- Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
- Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

Neni 4

Shumat e kompensimit për anëtarët e organeve të Odës

- Shumat e kompensimit për anëtarët e organeve të Odës përcaktohen si në vijim:
 - Kryetari i Odës - Kompensim prej njëmijë (1000) euro në muaj, dhe
 - Anëtarët e Bordit Drejtues të Odës, anëtarët e Komisionit Disiplinor të Odës, Komisionit të Ankesave dhe Komisionit Mbikëqyrës të Odës, si dhe Komisioneve tjera të

Odës - Kompensim prej njëqind (100) euro për çdo mbledhje të mbajtur, por jo më shumë se gjashtë (6) mbledhje në muaj.

2. Kryetari të Odës dhe Drejtorit Ekzekutiv të Odës të cilët pranojnë kompensim mujor, nuk ju takon kompensimi për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit Drejtues të Odës.
3. Kompensimi i anëtarëve të grupeve punuese, këshillave profesional dhe grupeve të ekspertëve që themelohen nga Bordi Drejtues, përcaktohet në vlerë prej njëqind (100) euro për mbledhje, por jo më shumë se për katër (4) mbledhje në muaj.
4. Paga e Drejtorit Ekzekutiv të Odës dhe të punësuarve në Administratën e Odës përcaktohen me vendim të Bordit Drejtues të Odës në përputhje me buxhetin vjetor të Odës.

Neni 5

Kompensimet tjera

1. Kryetari të Odës dhe anëtarëve të organeve të Odës ju takon kompensim për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit, në rastet e përfaqësimit fizikisht të Odës dhe interesave të saj, jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
2. Shumat maksimale të kompensimeve nga paragrafi 1 janë si në vijim:
 - 2.1. Shpenzime të udhëtimit – deri në vlerë pesëqind (500) euro për vajtje-ardhje;
 - 2.2. Shpenzime të akomodimit – deri në vlerë njëqindepesëdhjetë (150) euro për një natë akomodim;
 - 2.3. Shpenzime të ushqimit – deri në vlerë njëqind (100) euro për një ditë qëndrim.
3. Të gjitha shpenzimet nga paragrafi 2 arsyetohen përmes faturave të rregullta dhe i nënshtrohen parimit të ekonomizimit, gjegjësisht shpenzimeve minimale dhe vlerës për para.
4. Kryetari dhe anëtarëve të Bordit Drejtues nuk ju takojnë shpenzimet nga ky Nen, në rast të mbulimit të shpenzimeve përkatëse nga pala pritëse apo ndonjë donator tjetër.
5. Anëtarëve tjerë të Odës që autorizohen nga Kryetari i Odës të përfaqësojnë Odën dhe interesat e saj, ashtu siç përcaktohet me Statutin e Odës, ju takon kompensimi i shpenzimeve nga ky Nen.

Neni 6

Ndalesat

1. Për shërbimin në Komisionin Vlerësues dhe Komisionet e tjera të Bordit, anëtarëve të Bordit nuk ju lejohet kompensim shtesë përveç kompensimit të rregullt që e marrin anëtarët për shërbimin e tyre si anëtar të Bordit të Drejtues.
2. Për shërbimin në grupet punuese, këshillat profesional dhe grupet e ekspertëve të themeluara nga Bordi, anëtarëve të Bordit Drejtues të Odës, anëtarëve të Komisionit Disiplinor të Odës, Komisionit të Ankesave dhe Komisionit Mbikëqyrës të Odës, si dhe Komisioneve tjera të Odës, nuk ju lejohet kompensim shtesë përveç kompensimit të rregullt që e marrin anëtarët për shërbimin e tyre si anëtar të Bordit të Drejtues apo të Komisioneve përkatëse.
3. Kompensimet sipas kësaj Rregulloreje ekzekutohen vetëm nëse arsyetohet se mbledhjet, akomodimet apo vizitat jashtë Kosovës janë në interes të Odës dhe anëtarësisë së vet.

Neni 7

Kufizimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës

Kompensimet dhe pagat nga kjo Rregullore i nënshtrohen kufizimeve gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës, siç përcaktohen me Ligjin në fuqi dhe Statutin e Odës.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuçi

Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës